

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1028 Prot.

Tiranë, më 02.08 2017

VENDIM Nr. 158, datë 26.07.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërbimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.10, datë 26.07.2017, pasi shqyrtoi Raportin e Sondazheve Arkeologjike në korridorin e ndërtimit "*Linja e Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP)*" në zonën e Beratit- *Tozhar KM 125+100; Konceptin dhe metodologjinë e kryerjes së Gërmimit arkeologjik të shpëtimit në këtë zonë*-subjekti "SPIECAPAG Shqipëria", paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k..

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Sondazheve Arkeologjike në korridorin e ndërtimit "*Linja e Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP)*" në zonën e Beratit - *Tozhar KM 125+100; Konceptin dhe metodologjinë e kryerjes së Gërmimit arkeologjik të shpëtimit në këtë zonë*-subjekti "SPIECAPAG Shqipëria", paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.
2. Gërmimi arkeologjik i shpëtimit do të kryhet nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k., në vijim të akt-marrëveshjes së mëparshme të lidhur për kryerjen e sondazheve arkeologjike në këtë zonë, ndërmjet "SPIECAPAG Shqipëria", kësaj shoqërie dhe Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë shoqëri. Raporti i Gërmimit arkeologjik të shpëtimit të paraqitet në KKA e radhës.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO